



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 16 korrik 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar
për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Listës së Dëshmitarëve dhe
Pika të Tjera që Lidhen me Të**

T'i njoftohet:

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit
Julius von Bone

Mbrojtëses së viktimave
Ani Pues

TRUPI GJYKUES I (“Trupi Gjykues”) nxjerr vendimin më poshtë lidhur me kërkesën e Prokurorit të Specializuar për ndryshimin e listës së provave materiale dhe listës së dëshmitarëve dhe pika të tjera që lidhen me to.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 15 shkurt 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi dosjen paraprake, listën e dëshmitarëve (“Lista e Dëshmitarëve të ZPS-së”) dhe listën e provave materiale (“Lista e Provave Materiale të ZPS-së”), në përputhje me rregullën 95(4) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”).¹
2. Më 7 maj 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi Trupit Gjykues dosjen e çështjes, në përputhje me rregullën 98 të Rregullores.²
3. Më 9 qershor 2021, Trupi Gjykues mbajti konferencën e parë përgatitore për gjykim (“Konferenca Përgatitore për Gjykimin”).³ Më 9 dhe 10 qershor 2021, u mbajtën edhe dy konferenca të tjera përgatitore për gjykim, në seancë të mbyllur.⁴

¹ KSC-BC-2020-05, F00082, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Dosjes Paraprake me Listën e Dëshmitarëve dhe Listën e Provave Materiale*, 15 shkurt 2021, publik, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versionet e redaktuara konfidenciale të Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale të ZPS-së u dorëzuan më 17 shkurt 2021, F00085/A02 dhe F00085/A03. Versioni i korrigjuar i Dosjes Paraprake u protokollua më 23 shkurt 2021, në version rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00088/A01) dhe version të redaktuar konfidencial (F00088/A02).

² KSC-BC-2020-05, F00119, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Kalimin e Dosjes Gjyqësore Trupit Gjykues I*, 7 maj 2021, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe shtojcën 2, konfidenciale.

³ KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës (“Transkripti Publik i 9 qershorit 2021”), 9 qershor 2021, publik.

⁴ Transkript i seancës, 9 qershor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; Transkript i seancës, 10 qershor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

4. Më 18 qershor 2021, Trupi Gjykses vendosi që gjykimi të fillojë më 15 shtator 2021.⁵ Gjithashtu, në vijim të një kërkesë të ZPS-së,⁶ Trupi Gjykses urdhëroi ZPS-në që brenda të mërkurës, 30 qershor 2021, të dorëzonte një kërkesë për ndryshimin e Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale të ZPS-së, në përputhje me rregullën 118(2) të Rregullores.⁷
5. Më 30 qershor 2021, ZPS-ja dorëzoi kërkesën (“Kërkesa”).⁸
6. Mbrojtja e Salih Mustafës (përkatësisht, “Mbrojtja” dhe “i akuzuari”) nuk iu përgjigj Kërkesës.

II. PARASHTRIMET

7. ZPS-ja kërkon⁹ të përfshijë në Listën e Provave Materiale të saj siç vijon: (i) harta të zonës së Prishtinës;¹⁰ (ii) fotografi të vendndodhjes aktuale të ish-kompleksit të ndalimit në Zllash ([REDAKTUAR]),¹¹ me notën zyrtare shoqëruese;¹² (iii) transkriptet e dy intervistave plotësuese të ZPS-së me dëshmitarët W01679 ([REDAKTUAR])¹³ dhe W03593 ([REDAKTUAR])¹⁴, dhe provat materiale shoqëruese;¹⁵ (iv) transkriptet e një

⁵ KSC-BC-2020-05, F00138, Trupi Gjykses I, *Vendim për Caktimin e Datës për Fillimin e Gjyimit dhe Çështje të Lidhura me Të* (“Vendimi mbi Datën e Fillimit të Gjyimit”), 18 qershor 2021, publik, para. 17 dhe 22(f).

⁶ KSC-BC-2020-05, F00130, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në përputhje me KSC-BC-2020-05/F00123* (“Parashtrimet e ZPS-së për Konferencën Përgatitore për Gjykimin”), 2 qershor 2021, publike, para. 5-6; KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 9 qershor 2021, publik, f. 210-212.

⁷ Vendimi mbi Datën e Fillimit të Gjyimit, para. 10 dhe 22(b).

⁸ KSC-BC-2020-05, F00145, Trupi Gjykses I, *Kërkesë e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Listës së Dëshmitarëve të ZPS-së* (“Kërkesa”), 30 qershor 2021, konfidenciale, me shtojcat 1 dhe 3, konfidenciale, dhe shtojcën 2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik i Kërkesës u dorëzua më 1 korrik 2021, F00145/RED.

⁹ Kërkesa, para. 3.

¹⁰ Shtojca 1 e Kërkesës, materiali 1.

¹¹ Shtojca 1 e Kërkesës, materiali 2.

¹² Shtojca 2 e Kërkesës, materiali 1.

¹³ Shtojca 2 e Kërkesës, materiali 2.

¹⁴ Shtojca 2 e Kërkesës, materiali 4.

¹⁵ Për W01679-ën, Shtojca 2 e Kërkesës, materiali 3; për W03593-shin, Shtojca 2 e Kërkesës, materiali 5.

interviste të ZPS-së me dëshmitarin W04849 ([REDAKTUAR]);¹⁶ dhe (v) [REDAKTUAR],¹⁷ [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR]).¹⁸ Gjithashtu, ZPS-ja kërkon të përfshijë dëshmitarin W04849 në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së.¹⁹

8. ZPS-ja argumenton se ndryshimet e kërkuara nuk i shkaktojnë asnjë dëm Mbrojtjes sepse: (i) materiali përkatës ose përmban informacion të disponueshëm publikisht, ose [REDAKTUAR];²⁰ (ii) intervistat plotësuese të W01679-ës dhe W03593-shit janë të shkurtra dhe në to diskutohet vetëm [REDAKTUAR];²¹ dhe (iii) Kërkesa është bërë mjaft përpara fillimit të gjyqimit dhe Mbrojtja është njoftuar në kohë lidhur me shtesat e synuara.²²

9. Në lidhje me disa nga këto prova materiale shtesë, ZPS-ja kërkon masat e mëposhtme mbrojtëse:

- a) autorizim për zbatimin e redaktimeve në materialin 1 të Shtojcës 2 të Kërkesës, që është një notë zyrtare e ZPS-së lidhur me vizitën e saj në Zllash, për të mbrojtur informacionin që nuk i është nxjerrë ende të akuzuarit, si dhe autorizim për nxjerrjen e versionit të paredaktuar të këtij materiali 30 ditë para dëshmisë së dëshmitarit të parë të ZPS-së në gjyq;²³
- b) autorizim për zbatimin e redaktimeve në materialet 2-5 të Shtojcës 2, për zbatimin e masave mbrojtëse të miratuara më parë për W01679-ën dhe W03593-shin në këtë çështje gjyqësore dhe rrjedhimisht nxjerrjen e versioneve të paredaktuara të këtyre materialeve 30 ditë para dhënies së dëshmive të tyre përkatëse;²⁴ dhe

¹⁶ Shtojca 1 e Kërkesës, materiali 3.

¹⁷ Shtojca 1 e Kërkesës, materiali 4; Shtojca 2 e Kërkesës, materiali 7.

¹⁸ Shtojca 2 e Kërkesës, materiali 6 dhe 8.

¹⁹ Kërkesa, para. 4.

²⁰ Kërkesa, para. 5(i), (iii)-(iv).

²¹ Kërkesa, para. 5(ii).

²² Kërkesa, para. 5(v)-(vi).

²³ Kërkesa, para. 7.

²⁴ Kërkesa, para. 8.

- c) autorizim për mosnxjerrjen e përkohshme të materialeve 6-8 të Shtojcës 2, për të mbrojtur [REDAKTUAR], dhe autorizim për t'ia nxjerrë këto materiale Mbrojtjes 30 ditë para dëshmisë së dëshmitarit të parë në gjyq.²⁵

10. ZPS-ja argumenton se masat e kërkuara janë të domosdoshme, pasi janë masat më pak kufizuese në dispozicion për t'u ofruar mbrojtjen e duhur dëshmitarëve në fjalë dhe për të garantuar masat e miratuara më parë ose [REDAKTUAR], dhe se ato janë proporcionale, sepse Mbrojtja do të ketë qasje në dokumentet e plota dhe të paredaktuara sapo të nxirret identiteti i dëshmitarëve në fjalë, dhe/ose një muaj para dhënies së dëshmisë së dëshmitarit të parë të ZPS-së.²⁶

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Në pajtim me rregullën 118(2) të Rregullores, pasi merr njoftim në kohë dhe i tregohen arsye të vlefshme, trupi gjykues mund të lejojë ndryshim të listave të dëshmitarëve dhe të provave materiale të dorëzuara në përputhje me rregullën 95(4)(b) të Rregullores.

12. Në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në zotërim të ZPS-së të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit, i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë procesit, vetëm me kufizimet rreptësisht të domosdoshme dhe me zbatimin e garancive mbrojtëse kompensuese të nevojshme.

13. Bazuar në nenin 23(1) të Ligjit dhe rregullat 80(1) dhe 108(1)(b) të Rregullores, një panel, *proprio motu*, ose me kërkesë të një pale, mund të urdhërojë masat e duhura për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e

²⁵ Kërkesa, para. 9.

²⁶ Kërkesa, para. 10-11.

dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dëshmitarëve.

14. Në përputhje me rregullën 108(1)(a) dhe (c) të Rregullores, ZPS-ja mund t'i bëjë panelit kërkesë për mosnxjerrjen e informacionit, në tërësi ose pjesërisht, kur nxjerrja e këtij informacioni mund të cenojë hetimet aktuale, ose hetimet e ardhshme ose të jetë në kundërshtim, për ndonjë arsye tjetër, me interesin publik ose të drejtat e palëve të treta.

15. Në përputhje me rregullën 108(3) dhe (4) të Rregullores, kur informacioni që është objekt i nxjerrjes nuk i nxirret Mbrojtjes, paneli - *proprio motu* ose me kërkesë të një pale - mund të miratojë masa kompensuese, për garantimin e të drejtës së të akuzuarit për gjykim të drejtë.

IV. ANALIZË

A. NDRYSHIMI I LISTËS SË PROVAVE MATERIALE DHE I LISTËS SË DËSHMITARËVE TË ZPS-SË

a) Afati i Kërkesës

16. Rregulla 118(2) e Rregullores përcakton që kërkesa e ZPS-së për ndryshime të njoftohet në kohë. Lidhur me këtë, Trupi Gjyqësor rikujton se gjykimi do të fillojë më 15 shtator 2021.²⁷ Trupi Gjyqësor më tej thekson se shumica e materialeve në fjalë kanë dalë vetëm rishtazi, si rezultat i veprimtarive hetimore vijuese. Megjithatë, ZPS-ja menjëherë vuri në dijeni Trupin Gjyqësor, palët dhe mbrojtësen e viktimave për Kërkesën, duke bërë të ditur synimin për ndryshimin e Listës së Provave Materiale në parashtrimet e veta për Konferencën Përgatitore për Gjykimin²⁸ dhe duke i informuar palët për synimin e vet për të ndryshuar Listën e Dëshmitarëve gjatë vetë

²⁷ Vendimi mbi Datën e Fillimit të Gjyimit, para. 22(f).

²⁸ Parashtrimet e ZPS-së për Konferencën Përgatitore për Gjykimin, para. 5-7.

Konferencës Përgatitore për Gjykimin.²⁹ Trupi Gjykes konstaton se Mbrojtja do të ketë kohë të mjaftueshme për të vlerësuar materialin, në përputhje me të drejtën e vet për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së të akuzuarit.³⁰ Për rrjedhojë, Trupi Gjykes konstaton se Kërkesa është paraqitur në kohë.

b) Lista e Provave Materiale të ZPS-së

17. Për sa i përket materialeve 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Kërkesës, Trupi Gjykes konstaton se ato përmbajnë informacion të disponueshëm publikisht (harta topografike dhe fotografi të një vendndodhjeje publike) që përgjithësisht mund t'i ndihmojnë palët dhe Trupin Gjykes në vlerësimin e provave dhe kryerjen e procesit gjyqësor. Trupi Gjykes konstaton se Mbrojtjes nuk i shkaktohet asnjë dëm nga përfshirja e tyre në Listën e Provave Materiale të ZPS-së.³¹ Në lidhje me materialet 2-5 të Shtojcës 2 të Kërkesës, do të thotë intervistat plotësuese të W01679-ës dhe W03593-shit (dhe provat materiale shoqëruese), Trupi Gjykes vë në dukje se në to kryesisht diskutohen fotografi të Kompleksit të Ndalimit në Zllash, [REDAKTUAR].³² Gjithashtu, Trupi Gjykes vëren se këto intervista janë kryer [REDAKTUAR], të cilat u dorëzuan pas dorëzimit të Listës së Dëshmitarëve të ZPS-së.³³ Sa i takon materialit 4 të Shtojcës 1 dhe materialeve 6-8 të Shtojcës 2, [REDAKTUAR], Trupi Gjykes vë në dukje se shqyrtimi i [REDAKTUAR] përfundoi vetëm pas dorëzimit të Listës së Provave Materiale të ZPS-së.³⁴ Mbi të gjitha, Trupi Gjykes rikujton se [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]. Në lidhje me këtë, gjatë vlerësimit të kërkesës së ZPS-së për ndryshimin e Listës së Provave Materiale kundrejt mbrojtjes së të drejtës së të

²⁹ Transkripti Publik i 9 qershorit 2021, f. 211, rreshtat 2-8.

³⁰ *Shih* neni 21(4)(c) i Ligjit.

³¹ Si rrjedhojë, e njëjta vlen për materialin 1 të Shtojcës 2, i cili është Notë Zyrtare në lidhje me vizitën e ZPS-së në Zllash dhe vendndodhje të tjera.

³² [REDAKTUAR].

³³ [REDAKTUAR].

³⁴ *Shih* Shtojca 2 e Kërkesës, materiali 6 dhe 8.

akuzuarit për gjykim të drejtë, Trupi Gjykses [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].³⁵ Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka treguar arsye të vlefshme për ndryshimin e kërkuar të Listës së Provave Materiale të ZPS-së, çka nuk ndikon negativisht në mundësinë e të akuzuarit për t'u përgatitur siç duhet për gjykim.

c) Lista e Dëshmitarëve të ZPS-së

18. Për sa i përket kërkesës së ZPS-së për të përfshirë dëshmitarin W04849 në Listën e Dëshmitarëve të saj, Trupi Gjykses vë në dukje se dëshmitari në fjalë [REDAKTUAR].³⁶ Gjatë vlerësimit të së drejtës së ZPS-së për të kërkuar ndryshim të Listës së Dëshmitarëve të saj kundrejt të drejtës së të akuzuarit për të pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij, Trupi Gjykses i kushton rëndësi të veçantë faktit se [REDAKTUAR].³⁷ Trupi Gjykses vëren më tej se Mbrojta nuk e kundërshtoi këtë pjesë të Kërkesës, as me shkrim dhe as gjatë Konferencës Përgatitore për Gjykimin ku ZPS-ja bëri me dije synimin e vet për të përfshirë edhe një dëshmitar në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së.³⁸ Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka paraqitur arsye të vlefshme për përfshirjen e W04849-ës në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe se përfshirja e W04849-ës nuk cenon të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë. Për këto arsye, Trupi Gjykses gjithashtu autorizon ZPS-në të përfshijë transkriptin e intervistës së W04849-ës (materiali 3 i Shtojcës 1 të Kërkesës) në Listën e Provave Materiale të ZPS-së.

³⁵ Kërkesa, poshtëshënimi 11.

³⁶ [REDAKTUAR].

³⁷ Shtojca 1 e Kërkesës, materiali 3, [REDAKTUAR], f. 9, rreshtat 8-9; *shih edhe* Kërkesa, poshtëshënimi 10.

³⁸ Transkripti Publik i 9 qershorit 2021, f. 213, rreshtat 11-18.

B. MASAT MBROJTËSE

19. Sikurse përcaktohet në Vendimin Kornizë për Nxjerrjen e Provave,³⁹ standardi ligjor për të përcaktuar nëse një informacion i caktuar mund të mos i jepet palës marrëse, përfshin vlerësimin nëse: (i) nxjerrja e informacionit për palën marrëse konkrete, për ndryshim nga nxjerrja për publikun, përbën rrezik objektivisht të arsyetueshëm për personin ose interesin e mbrojtur; (ii) masa mbrojtëse është rreptësisht e domosdoshme. Si rrjedhojë, nëse janë të mjaftueshme dhe të realizueshme masa mbrojtëse më pak kufizuese, atëherë duhet të zgjidhen masa mbrojtëse të tilla; dhe (iii) masa mbrojtëse është proporcionale kundrejt cenimit që i shkaktohet të akuzuarit dhe gjykimit të drejtë.

a) Redaktimet dhe shtyrja e nxjerrjes së materialit të paredaktuar

20. Në lidhje me materialin 1 të Shtojcës 2 të Kërkesës, Trupi Gjykes vëren se redaktimet e kërkuara kanë të bëjnë me [REDAKTUAR], i cili aktualisht nuk i është nxjerrë të akuzuarit. Trupi Gjykes vëren se në këtë çështje, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka miratuar vazhdimisht redaktime të [REDAKTUAR].⁴⁰ Për të mos rënë ndesh me masat mbrojtëse ekzistuese, Trupi Gjykes gjykon se është e nevojshme të mbajë të njëjtat masa lidhur me materialin 1 të Shtojcës 2 të Kërkesës, pasi nuk ekzistojnë masa më pak kufizuese që do të eliminonin apo pakësonin rreziqet ndaj dëshmitarëve në këtë çështje gjyqësore. Për sa i përket proporcionalitetit të këtyre

³⁹ KSC-BC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje Përkatëse*, 9 tetor 2020, publik, para. 76.

⁴⁰ KSC-BC-2020-05, F00041/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit të Parë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, ("Vendimi i Parë për Masa Mbrojtëse"), 20 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 39(a)-(b); F00053/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit të Dytë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse* ("Vendimi i Dytë për Masa Mbrojtëse"), 24 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 51(a)-(e); F00090/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit të Tretë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse* ("Vendimi i Tretë për Masa Mbrojtëse"), 1 mars 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 19(a)-(d).

masave, Trupi Gjykues vë në dukje se i akuzuari do të marrë versionin e paredaktuar të materialit 30 ditë para dëshmisë së dëshmitarit të parë në gjyq, i cili pritet të paraqitet më 20 shtator 2021.⁴¹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se masa e kërkuar është proporcionale dhe nuk cenon në mënyrë të papërligjur të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë. Për këtë arsye, Trupi Gjykues autorizon ZPS-në të zbatojë redaktimin e propozuar në materialin 1 të Shtojcës 2 dhe të shtyjë nxjerrjen e versionit të paredaktuar të materialit të sipërpërmendur deri 30 ditë para dhënies së dëshmisë së dëshmitarit të parë të ZPS-së.

21. Në lidhje me materialet 2-5 të Shtojcës 2 të Kërkesës, Trupi Gjykues rikujton se për W01679-ën dhe W03593-shin në këtë çështje gjyqësore janë miratuar masat mbrojtëse vijuese: (i) [REDAKTUAR];⁴² (ii) [REDAKTUAR];⁴³ (iii) [REDAKTUAR];⁴⁴ dhe (iv) [REDAKTUAR].⁴⁵ Trupit Gjykues tani i kërkohet të vendosë nëse mund të redaktohen materialet shtesë lidhur me këta dëshmitarë, në përputhje me masat mbrojtëse ekzistuese.

22. Trupi Gjykues përfshin përmes referimit konstatimet e mëparshme të Gjykatësit të Procedurës Paraprake se ekziston rrezik objektivisht i arsyeshëm për W01679-ën dhe W03593-shin si pasojë e nxjerrjes së identitetit të tyre Mbrojtjes.⁴⁶ Sa i takon domosdoshmërisë së masave të kërkuara, Trupi Gjykues konstaton se redaktimet e kërkuara janë të domosdoshme për të mos rënë ndesh me masat mbrojtëse ekzistuese dhe, nga ana tjetër, për të mbrojtur identitetin e dëshmitarëve. Në këtë drejtim, Trupi Gjykues gjykon se nuk ka masa më pak kufizuese që do të eliminonin ose pakësonin rreziqet për këta dëshmitarë. Së fundi, Trupi Gjykues rikujton se Mbrojtja do t'i marrë

⁴¹ Vendimi mbi Datën e Fillimit të Gjykimit, para. 20.

⁴² Vendimi i Parë për Masa Mbrojtëse, para. 39(b).

⁴³ Vendimi i Parë për Masa Mbrojtëse, para. 39(a)-(b); Vendimi i Dytë për Masa Mbrojtëse, para. 51(a).

⁴⁴ Vendimi i Dytë për Masa Mbrojtëse, para. 51(b); Vendimi i Tretë për Masa Mbrojtëse, para. 19(d).

⁴⁵ Vendimi i Parë për Masa Mbrojtëse, para. 39(c).

⁴⁶ Vendimi i Parë për Masa Mbrojtëse, para. 19, 22.

të gjitha materialet në lidhje me këta dëshmitarë, në version të përdaktuar, kur të nxirret identiteti i tyre, si dhe do të ketë qasje në të gjitha provat dhe dëshmitë e plota të dëshmitarëve në sallën e gjyqit. Trupi Gjykses vlerëson se këto janë masa të përshtatshme kompensuese në rrethanat aktuale për garantimin e të drejtës së të akuzuarit për gjykim të drejtë. Duke mbajtur parasysh edhe faktin se kuadri i materialeve të sipërpërmendura është i kufizuar, pasi intervistat kryesisht kanë për synim [REDAKTUAR], Trupi Gjykses konstaton se masat e kërkuara janë proporcionale. Si rrjedhojë, Trupi Gjykses autorizon ZPS-në të zbatojë redaktimet e propozuara në materialet e përfshira në Shtojcën 2 të Kërkesës në lidhje me W01679-ën (materialet 2 dhe 3) dhe W03593-shin (materialet 4 dhe 5) dhe të shtyjë nxjerrjen për Mbrojtjen të versioneve të përdaktuara të materialeve të sipërpërmendura deri 30 ditë para dhënies së dëshmimeve të tyre përkatëse.

b) Kërkesa për mosnxjerrjen e materialit

23. Në lidhje me materialet 6-8 të Shtojcës 2 të Kërkesës, Trupi Gjykses rikujton se mosnxjerrja e përkohshme e të gjitha dokumenteve për Mbrojtjen, megjithëse e lejueshme, është një masë e jashtëzakonshme, pasi mund të cenojë Mbrojtjen.⁴⁷ Sidoqoftë, në rrethanat e çështjes konkrete, pasi ka shqyrtuar më kujdes materialet e sipërpërmendura, Trupi Gjykses vëren se ato përmbajnë [REDAKTUAR], [REDAKTUAR]. Për sa kohë Mbrojtja do t'i marrë materialet e përdaktuara, të përfshira në materialet 6-8 të Shtojcës 2 të Kërkesës, 30 ditë para dhënies së dëshmisë së dëshmitarit të parë të ZPS-së, i cili pritët të paraqitet më 20 shtator 2021,⁴⁸ Trupi Gjykses konstaton se masat e kërkuara janë proporcionale dhe nuk cenojnë në mënyrë të papërligjur të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses autorizon ZPS-në të shtyjë nxjerrjen për Mbrojtjen të informacionit të

⁴⁷ Vendimi i Dytë për Masa Mbrojtëse, para. 16, 44.

⁴⁸ Vendimi mbi Datën e Fillimit të Gjykimit, para. 20.

përfshirë në materialin 6-8 të Shtojcës 2 të Kërkesës deri 30 ditë para dhënies së dëshmisë së dëshmitarit të parë të ZPS-së.

C. KLASIFIKIMI I F00130/A02

24. Trupi Gjykses rikujton se ZPS-së i ka kërkuar parashtrime në lidhje me klasifikimin aktual të parashtrimit të protokolluar F00130/A02.⁴⁹ ZPS-ja argumenton që ky dokument duhet të mbetet rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, sepse numri i redaktimeve të nevojshme do ta bënte këtë dokument të pakuptueshëm.⁵⁰ Për këtë arsye, ZPS-ja propozon të nxjerrë një version të redaktuar (minimalisht) konfidencial të parashtrimit të protokolluar F00130/A02 sapo identiteti i dëshmitarit të parë të ZPS-së, përfshirë deklaratat e paredaktuara të dëshmitarit, t'i nxirren Mbrojtjes.⁵¹

25. Trupi Gjykses e vlerëson justifikimin e ZPS-së si të arsyeshëm dhe, për rrjedhojë, urdhëron ZPS-në të dorëzojë versionin e redaktuar konfidencial të parashtrimit të protokolluar F00130/A02 sapo identiteti i dëshmitarit të parë të ZPS-së, përfshirë deklaratat e paredaktuara të dëshmitarit, t'i nxirren Mbrojtjes.

V. VENDIM

26. Për arsyet e përmendura më lart, Trupi Gjykses:

- a. **AUTORIZON** ZPS-në të përfshijë në Listën e Provave Materiale të ZPS-së materialet e renditura në Shtojcën 1 dhe 2 të Kërkesës;
- b. **AUTORIZON** ZPS-në të përfshijë W04849-ën në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së;

⁴⁹ Vendimi mbi Datën e Fillimit të Gjykimit, para. 22(k).

⁵⁰ KSC-BC-2020-05, F00139, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Konfidencial i Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Riklasifikimin e F00130/A02* ("Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me F00130/A02"), 25 qershor 2021, konfidencial, para. 2-6.

⁵¹ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me F00130/A02, para. 7.

- c. **AUTORIZON** ZPS-në t'i nxjerrë Mbrojtjes materialet 1-5, të përfshira në Shtojcën 2, në formë të redaktuar, me redaktimet e propozuara;
- d. **AUTORIZON** ZPS-në të shtyjë nxjerrjen e versionit të paredaktuar të materialit 1 të Shtojcës 2 të Kërkesës deri 30 ditë para dhënies së dëshmisë së dëshmitarit të parë të ZPS-së;
- e. **AUTORIZON** ZPS-në të shtyjë nxjerrjen për Mbrojtjen të versioneve të paredaktuara të materialeve 2-3 të Shtojcës 2 të Kërkesës (në lidhje me W01679-ën) dhe materialeve 4-5 në të njëjtën Shtojcë (në lidhje me W03593-shin) deri 30 ditë para dhënies së dëshmimeve të tyre përkatëse;
- f. **AUTORIZON** ZPS-në të mos i nxjerrë Mbrojtjes materialet 6-8 në Shtojcën 2 të Kërkesës deri 30 ditë para dhënies së dëshmisë së dëshmitarit të parë të ZPS-së;
- g. **URDHËRON** ZPS-në të nxjerrë materialin e përmendur më lart, me redaktimet e autorizuara, si dhe të dorëzojë Listën e Provave Materiale dhe Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së, të ndryshuara, brenda **të premtes, 30 korrik 2021**; dhe
- h. **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë versionin e redaktuar konfidencial të parashtrimit të protokolluar F00130/A02 sapo identiteti i dëshmitarit të parë të ZPS-së, përfshirë deklaratat e paredaktuara të dëshmitarit, t'i nxirren Mbrojtjes.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nëshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nëshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E premte, 16 korrik 2021

Në Hagë, Holandë